



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 300/12 Prot.

Tiranë, më 14. 08. 2025

V E N D I M

Nr. 202, Datë 14. 08. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është administruar ankesa nr. 46, datë 24.02.2025, e paraqitur nga z. I. Gj., i cili pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit ndërqytetas Lezhë-Tiranë-Lezhë, që operohet nga Shoqëria e Transportit të udhëtarëve “Linda-80” sh.p.k, me numër NIPT K37513530U.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, z. I. Gj., pretendon se më datë 09.02.2025 ka udhëtuar nga qyteti i Lezhës drejt qytetit të Tiranës, në orën 14:00, me autobusin me targë AA 159 TH. Gjatë udhëtimit, faturinoja ka filluar të mbledhë lekët, ankuesi së bashku me lekët 50% të vlerës së udhëtimit, i ka treguar edhe librezën e verbërisë. Faturinoja i ka kërkuar që të paguante biletën e plotë të udhëtimit, duke mos iu njohur e drejta për një zbritje prej 50% sipas ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996, "Për Statusin e të Verbërve", i ndryshuar. Gjithashtu, ankuesi i ka kërkuar që të merrte biletën, ndërkohë që autobusi nuk ishte i pajisur me biletë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen masave për eliminimin e pasojave që vijnë nga kjo formë diskriminimi.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.*

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Në kushtet kur, ankuesit nuk kishin mundur të identifikonin subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Lezhë-Tiranë, me të cilën kishin udhëtuar në datën 09.02.2025, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese, Komisioneri me shkresën nr. 300/3 prot., datë 25.02.2025, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim.

Me shkresën nr. 4280/1 , datë 27.02.2025¹, DPSHTRR, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi i kryer në sistemin e-Transport, rezultoi se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Lezhë-Tiranë-Lezhë, është licencuar shoqëria “Linda-80” sh.p.k..*

Pas plotësimit të ankesës dhe identifikimit të subjektit, u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa objekt shqyrtimi plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 dhe 334 të LMD. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj, duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr. 300/5 prot., datë 04.03.2025, Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen nga Shoqëria “Linda-80” sh.p.k., si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa.
- Me shkresën nr. 300/6 prot., datë 17.03.2025 është administruar pranë Komisionerit, shkresa nr.137 prot., datë 12.03.2025 e Shoqërisë “Linda-80” sh.p.k., me anë të cilës informon Komisionerin në lidhje me këtë çështje, ku informon se:

Me shkresën tuaj nr. 300/4, datë 04.03.2025, me titull “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, drejtuar subjektit “Linda-80” sh.p.k., Lezhë, ju na keni informuar mbi ankesën e shtetasit z. I. Gj., i cili pretendon se është diskriminuar nga faturinoja i autobusit me targa AA 159 TH, gjatë udhëtimit nga qyteti i Lezhës drejt Tiranës, pasi këtij të fundit i është kërkuar të kryejë pagesën e plotë të çmimit të transportit dhe jo 50%, për shkak të statusit të verbërisë, i provuar me librezën përkatëse.

Së pari, ju përgëzojmë ju si Komisioner për mbrojtjen që i bëni kategorive që gëzojnë status të veçantë – në këtë rast, statusin e të verbërit – pasi janë kategori që meritojnë vëmendje të veçantë dhe duhet të përfitojnë nga lehtësirat që parashikon ligji.

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, konkretisht neni 11, parashikon se: “Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.”

Shoqëria “Linda-80” sh.p.k., me NIPT K37513530U, është një subjekt me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e transportit, e licencuar sipas legjislacionit në fuqi, dhe ushtron aktivitetin e saj duke respektuar kushtet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2011,

¹ Administruar pranë Komisionerit me nr.300/4 prot., datë 03.03.2025.

“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.

Për sa më sipër, nga hetimi i bërë, për rastin edhe pse nuk provohet pretendimi i ankuesit për fatorinon, ju informojmë se z. I. Gj., mund të paraqitet pranë zyrave tona dhe do të kompensohet nga ana jonë në përputhje me legjislacionin përkatës, përkatësisht ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”. Këto lehtësira që parashikon ligji për personat që gëzojnë status të veçantë do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha rastet që do të paraqiten në të ardhmen.

Sa i përket pretendimit të z. I. Gj., se është diskriminuar nga punonjësi i shoqërisë sonë, e hedhim poshtë me bindje të plotë, pasi nuk ka patur dhe nuk do të ketë asnjë lloj diskriminimi nga ana jonë. Theksojmë se edhe blloku i biletave ka qenë në vendin e caktuar në autobus.

Sipas nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Sipas këtij përkufizimi, të diskriminosh do të thotë të dallosh, përjashtosh apo kufizosh një person për shkak të statusit të tij. Në rastin konkret, shtetasi në fjalë nuk është diskriminuar, por është trajtuar i barabartë me qytetarët e tjerë, pasi faturinoja i ka kërkuar të paguajë tarifën e transportit si gjithë të tjerët.

Shoqëria “Linda-80” sh.p.k. gëzon një reputacion dhe eksperiencë shumëvjeçare në fushën e transportit të qytetarëve dhe ka qenë e do të jetë gjithmonë e kujdesshme në trajtimin e rasteve që kërkojnë vëmendje të veçantë, për shtetasit që gëzojnë statusin e të verbërit apo personave me aftësi të kufizuara.

- Me shkresën nr.300/7 prot., datë 20.03.2025, Komisioneri, informacionin e mësipërm ia vuri në dispozicion ankuesit për njohje dhe për të bërë parashtrimet e tija në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga e Shoqërisë “Linda-80” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 300/8 prot., datë 28.03.2025 janë administruar pranë Komisionerit, parashtrimet e ankuesit në lidhje me shkresën nr.137 prot., datë 12.03.2025 të Shoqërisë “Linda-80” sh.p.k., ku sqaron se: “Në përgjigje të shkresës suaj ju sqaroj se në lidhje me ngjarjen e datës 24.02.2025, unë kam denoncuar linjën e shërbimit të udhëtarëve Lezhë–Tiranë dhe anasjelltas. Kjo linjë nuk zbaton ligjin, duke më detyruar të paguaj biletën e plotë për vete dhe për shoqëruesin tim. Në këto kushte po ju drejtohem ju për të konstatuar diskriminimin. Shoqëria “Linda-80” ka dhënë pretendimet e saj ku thotë se është një shoqëri serioze dhe për rastin në fjalë ajo thotë se nu ka faturino. A është faji im? Përgjigja

e tyre duket e pasinqertë, sepse në çdo gjë që është bërë nga ana ime dhe personat e tjerë, shoqëritë po të njëjtën përgjigje japin. Që të mos përsëritet kjo ngjarje, unë kërkoj që Komisioneri të konstatojë diskriminimin.”

Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e ankuesit, caktoi datën 23.05.2025, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 300/9 prot., datë 05.05.2025.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan pretendimeve të parashtruara më herët edhe në komunikimin me shkrim. Nga ana e Shoqërisë “Linda-80” sh.p.k., u sqarua gjithashtu se biletat e autobusëve nuk priten më brenda në autobus, ashtu siç pretendon ankuesi, por në ambientet pranë stacionit të nisjes, ku çdo kompani transporti ka vendin e vet të posaçëm për shitjen e biletave. Shoqëria deklaroi se personeli është i informuar dhe i trajnuar për zbatimin e legjislacionit në fuqi, përfshirë dhe detyrimet ndaj personave me aftësi të kufizuara, për të cilët ofrohen bileta me çmim të reduktuar në masën 50%.

Gjithashtu, administratori i shoqërisë bëri me dije se autobusët e kësaj shoqërie janë të pajisur me vende të caktuara dhe të dedikuara për pasagjerët me aftësi të kufizuara. Ai theksoi se “Linda-80” sh.p.k. operon prej 25 vitesh në këtë fushë dhe ka trajnuar stafin e saj në mënyrë periodike për të respektuar detyrimet ligjore dhe standardet e shërbimit.

Në vijim të deklarimeve të administratorit, atij iu kërkua të vendosë në dispozicion prova që mbështesin sa është deklaruar në seancë. Shoqëria “Linda-80” sh.p.k., me email-in e datës 17.06.2025, dorëzoi fotografi të ambienteve të shitjes së biletave në terminalin e autobusëve, fotografi që dokumentojnë vendet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara në mjetet e transportit, si dhe kopje të biletave të lëshuara për këtë kategori pasagjerësh.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar nga institucionet dhe subjektet, informacionin e nevojshëm, lidhur me rastin e pretenduar nga pala ankuese, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë*

² Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.*”

informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat për identifikimin e subjektit që pretendohet të ketë kryer veprimin diskriminues, duke komunikuar me DPSHTRR dhe me subjektin ankues.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ankuesi, shtetasi I. Gj., ka paraqitur një ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke pretenduar se është diskriminuar gjatë udhëtimit me linjën e autobusit Lezhë–Tiranë të shoqërisë “Linda-80” sh.p.k., më datë 24.02.2025. Sipas tij, faturinoja i ka kërkuar të paguajë çmimin e plotë të biletës si për veten ashtu edhe për shoqëruesin e tij, ndonëse ai posedon librezën që vërteton statusin e të verbërit, çka sipas ligjit i jep të drejtën për udhëtim me gjysmë çmimi në linjat interurbane. Në parashtrimet e tij, ai ka vlerësuar se veprimi i shoqërisë përbën shkelje të legjislacionit në fuqi dhe ka kërkuar nga Komisioneri që të konstatojë ekzistencën e diskriminimit. Ai ka vënë në dukje se kjo nuk është një situatë e izoluar dhe se edhe persona të tjerë janë përballur me përgjigje të ngjashme nga shoqëritë e transportit, duke e konsideruar të pasinqertë justifikimin se faturinoja nuk ka qenë i trajnuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi ankesën, me shkresën nr. 300/5 prot., datë 04.03.2025, i ka kërkuar shoqërisë “Linda-80” sh.p.k. të japë informacion dhe dokumentacion për çështjen në fjalë. Në përgjigje të kësaj kërke, me shkresën nr. 137 prot., datë 12.03.2025 shoqëria ka deklaruar se është një subjekt i licencuar dhe me përvojë shumëvjeçare në fushën e transportit, që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo ka sqaruar se nuk vërtetohet situata e pretenduar të ketë ndodhur. Shoqëria ka shprehur gatishmërinë për të kompensuar ankuesin, duke e ftuar të paraqitet në zyrat e saj, dhe ka pohuar se trajton me kujdes të veçantë të gjitha rastet që lidhen me persona që gëzojnë status të veçantë, siç janë të verbërit apo ata me aftësi të kufizuara. Ajo ka mohuar me bindje të plotë çdo pretendim për diskriminim, duke theksuar se shtetasi në fjalë është trajtuar njësoj si të gjithë udhëtarët e tjerë dhe se marrja e biletave bëhet në vendin e caktuar për këtë shërbim. Gjithashtu është shprehur se për këtë kategori pasagjerësh ka bileta me tarifë 50% si dhe në mjetet e transportit të kësaj shoqërie ndodhen vendet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

Me shkresën nr. 300/7 prot., datë 20.03.2025, Komisioneri ia ka vënë në dispozicion ankuesit qëndrimin dhe sqarimet e shoqërisë për njohje dhe për të dhënë parashtrimet e tij. Më pas, me shkresën nr. 300/8 prot., datë 28.03.2025, janë administruar pranë Komisionerit parashtrimet e ankuesit, në të cilat ai i qëndron pretendimeve fillestare. Ai ka kërkuar sërish nga Komisioneri që të konstatohet fakti i diskriminimit, në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten për persona të tjerë që përfitojnë nga lehtësirat ligjore.

Me qëllim sqarimin e mëtejshëm të rrethanave dhe fakteve, Komisioneri, bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka caktuar zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 23.05.2025, ora 10:00. Gjatë seancës dëgjimore, palët i kanë qëndruar pretendimve të tyre të mëparshme. Shoqëria “Linda-80” sh.p.k. ka sqaruar se biletat nuk priten më brenda në autobus, por në ambientet përkatëse të stacionit të nisjes, ku çdo kompani ka vendin e saj të posaçëm për shitje. Shoqëria ka pohuar se personeli është i informuar dhe i trajnuar për zbatimin e ligjit për personat me aftësi të kufizuara, të cilët përfitojnë ulje në masën 50%. Po ashtu, administratori ka deklaruar se mjetet e transportit janë të pajisura me vende të dedikuara për këtë kategori dhe se shoqëria ka mbi 25 vite eksperiencë në këtë fushë, duke kryer trajnime të rregullta për stafin.

Në përfundim të seancës, administratorit të shoqërisë iu kërkua të vendoste në dispozicion prova mbështetëse për deklaratimet e bëra. Me email-in e datës 16.06.2025, shoqëria dorëzoi pranë Komisionerit fotografi të ambienteve të shitjes së biletave në terminal, foto të vendeve të dedikuara për persona me aftësi të kufizuara në mjetet e transportit si dhe kopje të biletave të lëshuara për këtë kategori.

Bazuar në të dhënat e administruara më sipër, Komisioneri, në kuadër të evidentimit të rastit, ka konstatuar se:

- Ankuesi z. I. Gj., pretendon se është diskriminuar gjatë udhëtimit në linjën Lezhë–Tiranë të shoqërisë “Linda-80” më 24.02.2025, pasi faturinoja i kërkoi pagesë të plotë pavarësisht statusit të tij të verbërit.
- Shoqëria “Linda-80” mohoi pretendimet dhe deklaroi se vepron në përputhje me ligjin dhe trajton me kujdes rastet e personave me aftësi të kufizuara.
- Shoqëria sqaroi se biletat shiten në stacion ku nisen mjetet e transportit dhe personeli është i trajnuar për ligjin që garanton ulje 50% për personat me aftësi të kufizuara.
- Shoqëria dorëzoi prova mbështetëse, përfshirë foto të ambienteve të biletarisë dhe biletave të lëshuara për këtë kategori.

Sa më sipër, pala ankuese nuk ka vënë në dispozicion informacion të plotë dhe prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj, siç është, për shembull, të dhëna të sakta për identifikimin e faturinos apo ndonjë dokument të udhëtimit që të mund të mbështeste konkretisht versionin e ngjarjes. Këto mungesa në dokumentacion dhe prova të drejtpërdrejta kanë kufizuar mundësinë e verifikimit të plotë të rrethanave të pretenduara.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në faktet dhe provat që janë vënë në dispozicion nga palët, si dhe atyre të grumbulluara gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk arriti të konstatojë se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë “Linda-80” sh.p.k.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shoqëria “Linda-80” sh.p.k, nuk duhet të gjendet përgjegjëse për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2024 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar në dëm të ankuesit, z. I. Gj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, z. I. Gj., në fushën e të mira dhe shërbimeve, nga ana e Shoqërisë “Linda-80” sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Rekomandohet Shoqëria “Linda-80” sh.p.k, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për mënyrën e ofrimit të udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA